

M. C. INERTE SHPK

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

Së bashku me Raportin e Audituesve të Pavarur

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	6
Pasqyra e Performancës dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare.....	8
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	9
Shënime mbi Pasqyrat Financiare.....	10
1. Informacione të përgjithshme	10
2. Bazat e përgatitjes	10
2.1 Deklarata e pajtueshmërisë	10
2.2 Baza e matjes	10
2.3 Parimi i vijimësisë.....	10
2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	10
2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	11
3. Mjetet monetare	12
4. Të drejta të arkëtueshme	12
5. Inventarët	12
6. Aktivet afatgjata materiale	13
7. Të pagueshme për aktivitetin	14
8. Të tjera të pagueshme afatgjata.....	14
9. Fitimi / Humbja e mbartur	14
10. Të ardhura të tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit.....	15
11. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15
12. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme.....	15
13. Shpenzime të tjera shfrytëzimi.....	16
14. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	16
15. Manaxhimi i riskut financiar.....	17
16. Palët e lidhura	17
17. Angazhime dhe pasiguri.....	18
18. Ngjarje pas datës së raportimit.....	18

M. C. INERTE SHPK

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Ortakun e Vetëm dhe Administratorin e shoqërisë M. C. INERTE SHPK

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë M. C. INERTE SHPK (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën individuale të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën individuale të fluksit të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri (SKK).

Baza për Opinionin me Rezervë

1. Siç është paraqitur në shënimin 4 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2022, kërkesat e arkëtueshme tregtare janë në vlerën 515,827,082 Lek (2021: 521,269,231 Lek). Si pjesë e procedurave të auditimit ne dërguam konfirmime direkte në palët e treta për shumat e arkëtueshme dhe deri në datën e këtij raporti nuk morëm konfirmime direkte apo akte rakordimi prej tyre. Nga procedurat analitike rezultoi se këto llogari lidhen me veprimtaritë e punimeve ndërtimore, janë me palë të lidhura dhe një pjesë e konsiderueshme janë më të vjetra se një vit. Për këto arsye si dhe për shkak të natyrës së mbajtjes së regjistrimeve, ne nuk arritëm të merrnim siguri të arsyeshme mbi ekzistencën e këtyre llogarive. Për këto arsye, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, si rrjedhojë e rregullimeve që mund të jenë të nevojshme të kryhen për llogaritë e arkëtueshme të klientëve.

2. Në shënimin 5 në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022, "Inventarët" paraqiten në vlerën 1,180,433,129 lekë (2021: 1,297,048,146 lekë). Për shkak se ne u emëruam si auditues mbas datës së mbylljes së vitit ushtrimor, ne nuk ishim të pranishëm në procesin e inventarizimeve vjetore të cilat shoqëria i ka realizuar në periudhën dhjetor 2022. Me gjithë procedurat e tjera të zbatuara, për shkak edhe të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë si edhe për shkak të mënyrës së ruajtjes së inventarëve, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me sasinë e inventarit në datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.

2. Siç paraqitet në shënimin 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2022, vlera e llogarive të pagueshme tregtare është 1,482,931,544 Lek (2021: 1,584,405,545 Lek). Ne nuk kemi mundur të fitojmë një siguri të arsyeshme për saktësinë e tyre as nëpërmjet letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave të tjera alternative, kjo edhe për shkak të natyrës së regjistrimeve kontabël të shoqërisë. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund të jetë i nevojshëm në lidhje me llogaritë e pagueshme tregtare si dhe efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit neto.

M. C. INERTE SHPK

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

4. Shoqëria duhet të paraqesë në pasqyrat financiare informacione mbi palet e lidhura si dhe detaje lidhur me riskun financiar ashtu sic parashikohet në SKK 2. Megjithatë, shoqëria nuk ka paraqitur asnjë informacion mbi transaksionet me palet e lidhura në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe ka paraqitur vetëm politikat e përdorura lidhur me ekspozimin ndaj riskut financiar.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Administratoreve dhe të Personave të Ngarkuar me Mbikqyrjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për të tilla kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.


M. C. INERTE SHPK

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

28 Korrik 2023



Sokol Toska
Auditues Ligjor



Rr. Tish Dahia, Kompleksi Kika 2
Kulla 2, Nr. 33
Tirana 1060, Albania
+355 683317751
contact@toska.al
L62207031A

M. C. INERTE SHPK

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
Me 31 Dhjetor 2022**

Nr	AKTIVET	Shenime	Date	Date
			31.12.2022	31.12.2021
I	Aktivët afatshkurtra		1,806,295,873	1,854,432,230
1	Mjete monetare	3	26,089,789	8,420,311
	▶ Banka		22,895,879	4,582,338
	▶ Arka		3,193,911	3,837,973
2	Të drejta të arkëtueshme	4	599,188,405	548,963,773
	▶ Nga aktiviteti i shfrytëzimit		515,827,082	521,269,231
	▶ Të tjera		83,361,323	27,694,542
3	Inventaret	5	1,180,433,129	1,297,048,146
	▶ Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme		14,575,851	1,347,936
	▶ Prodhim në proces dhe gjysëm produkte		1,145,217,608	1,295,700,210
	▶ Parapagime për inventare		20,639,670	
4	Shpenzime të shtyra		584,550	0
II	Aktivët afatgjata		370,495,033	354,950,146
1	Aktivët afatgjata financiare		70,000	70,000
2	Aktivët afatgjata materiale	6	370,425,033	354,880,146
	▶ Toka dhe Ndërtesa		256,280,969	264,838,044
	▶ Makineri dhe pajisje		103,024,682	82,695,203
	▶ Të tjera në shfrytëzim		11,119,382	7,346,899
	TOTALI I AKTIVEVE		2,176,790,907	2,209,382,376

Nr	DETYRIME DHE KAPITALI	Shenime	Date	Date
			31.12.2022	31.12.2021
I	Detyrime afatshkurtra		1,485,425,046	1,584,863,994
1	Tituj të huamarrjes		0	0
2	Detyrime tregëtare	7	1,485,425,046	1,584,863,994
	▶ Te pagueshme ndaj furnitoreve		1,482,931,544	1,584,405,545
	▶ Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimet		2,445,342	413,488
	▶ Detyrime për TAP-in		48,160	44,961
II	Detyrime afatgjata		205,533,459	149,410,750
1	Tituj të huamarrjes		0	0
	▶ Hua bankare		0	0
2	Te tjera afatgjata	8	205,533,459	149,410,750
	▶ Shuma të arketuara me porosi		145,719,944	88,960,021
	▶ Te tjera detyrime afatgjata		59,813,515	60,450,729
	TOTALI I DETYRIMEVE		1,690,958,505	1,734,274,744
III	KAPITALI		485,832,402	475,107,632
1	Kapitali i Nënshkruar		560,499,196	560,499,196
3	Fitim / Humbja e mbartur	9	-85,391,564	-100,255,528
4	Fitim / Humbja e vitit financiar		10,724,770	14,863,965
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,176,790,907	2,209,382,376

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi në datën 29.05.2023 dhe janë nënshkruar nga:

Megi Luli

Antonela Lushi

Administratore

Hartues



M. C. INERTE SHPK
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**Pasqyra e Performancës dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Periudha 2022	Periudha 2021
	Të ardhura		363,969,690	463,511,974
	Të ardhura të tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit	10	123,956,171	168,535,870
	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces		0	0
	Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar		0	0
	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	11	240,013,520	294,976,104
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	12	-238,641,761	-354,633,397
	▶ <i>Materiale</i>		-88,159,159	-127,312,396
	▶ <i>Kosto situacionet</i>		-150,482,602	-227,321,001
	Shpenzime të personelit		-26,403,810	-18,924,333
	▶ <i>Pagat</i>		-22,643,054	-16,217,097
	▶ <i>Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i>		-3,760,756	-2,707,236
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6	-31,690,924	-21,013,900
	Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	13	-54,599,163	-45,756,934
	Të ardhura të tjera		103,449	0
	Shpenzime financiare		0	0
	Fitimi (humbja) para tatimit		12,737,481	23,183,410
	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	14	-2,012,711	-8,319,446
	Fitimi (humbja) neto e vitit		10,724,770	14,863,964
12	Fitim / Humbja per:			
	> Pronaret e njesise ekonomike meme		10,724,770	14,863,964
	> Interesat jo-konrolluese		0	0
	Pasqyra e te Ardhurave Gjitheperفشیره			
Nr	Pershkrimi i elementeve			
1	Fitim / Humbja e vitit		10,724,770	14,863,964
	Te ardhura te tjera gjitheperفشیره per vitin:			
	Diferencat (+/-) nga perkethimi i monedhes ne veprimtari te huaja			
	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i Aktiveve Afatgjata Materiale			
	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i Aktiveve Financiare te mbajtura per shitje			
	Pjese e te ardhurave gjitheperفشیره nga pjesemarrjet			
2	Totali i te Ardhurave te tjera gjitheperفشیره per vitin		0	0
3	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		10,724,770	14,863,964
4	Totali i te Ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse per :			
	Pronaret e njesive ekonomike meme		10,724,770	14,863,964
	Interesat jo-konrolluese		0	0

Pasqyra e Performancës dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

M. C. INERTE SHPK
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

		2022	2021
▶	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
	<i>Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme</i>	426,171,762	866,820,778
	<i>Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve</i>	-357,567,893	-855,600,344
	<i>Pagesa të tjera</i>	0	0
	<i>Interes i paguar</i>	0	0
	<i>Tatim fitimi i paguar</i>	-3,698,580	-27,196,308
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	64,905,289	-15,975,874
▶	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
	<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>	0	0
	<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
	<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-51,015,476	-83,033,878
	<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	3,779,665	340,000
	<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
	<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
	<i>Dividentë të arkëtuara</i>		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-47,235,811	-82,693,878
▶	Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
	<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
	<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Hua të arkëtuara</i>	0	60,450,729
	<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
	<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>		
	<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Pagesa e huave</i>		
	<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
	<i>Interes i paguar</i>		
	<i>Dividendë të paguar</i>		
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0	60,450,729
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	17,669,478	-38,219,023
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	8,420,311	46,639,334
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	26,089,789	8,420,311

Pasqyra e Fluksive të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

M. C. INERTE SHPK**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

		<i>Kapitali aksionar</i>	<i>Fitimi pashperndare</i>	<i>Fitimi i vitit</i>	<i>TOTALI</i>
I	POZICIONI me 31 DHJETOR 2020	560,499,196	131,115,374	76,629,098	768,243,668
	Efekti ndryshimeve ne politikat kontabel				0
II	Pozicioni i rregulluar me 1 Janar 2021	560,499,196	131,115,374	76,629,098	768,243,668
1	Fitimi/humbja per periudhen kontabel		-308,000,000	14,863,965	-293,136,035
2	Destinimi I rezultatit		76,629,098	-76,629,098	0
III	Totali i te Ardhurave gjithepershiresë				0
1	Emetimi I kapitalit te nenshkruar				0
2	Fitim i transferuar ne kapital				0
IV	Totali i transaksioneve me pronaret				0
V	POZICIONI me 31 DHJETOR 2021	560,499,196	-100,255,528	14,863,965	475,107,632
	Efekti ndryshimeve ne politikat kontabel				0
VI	Pozicioni i rregulluar me 1 Janar 2022	560,499,196	-100,255,528	14,863,965	475,107,632
1	Fitimi/humbja per periudhen kontabel			10,724,770	10,724,770
2	Destinimi I rezultatit		14,863,965	-14,863,965	0
VII	Totali i te Ardhurave gjithepershiresë				0
1	Emetimi I kapitalit te nenshkruar				0
2	Fitim i transferuar ne kapital				0
VIII	Totali i transaksioneve me pronaret				0
IX	POZICIONI me 31 DHJETOR 2022	560,499,196	-85,391,564	10,724,770	485,832,402

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacione të përgjithshme

M. C. INERTE SHPK është një njesi, e themeluar dhe regjistruar, me numër unik J82020003H dhe organizohet në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare në Shqipëri.

Objekt kryesor i aktivitetit është Ndertime civile dhe ekonomike, projektim dhe kolaudim, etj. Tregti me shumice dhe pakice materiale ndertimi. Shërbime të tjera në fushën e ushqimit Social si : Bar Kafe, Restorante, tregti ushqimor me shumice dhe pakice, Hoteleri.

Selia e shoqërisë është në Tiranë, Njesia 7, Rruga Nexho Konomi, Zona Kadastrale 3866, Nr Pasurie 306/113.

M. C. INERTE SHPK është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, me kapital ligjor në vlerën 560,499,196 lekë, i paguar tërësisht, e zotëruar nga ortaku i vetëm, Z. Mark Luli.

Në aktivitetin e saj shoqëria përfaqësohet nga Administratorja, Znj. Megi Luli, e cila ushtron detyrën në përputhje me politikën e përcaktuar nga statuti pa kufizime të kompetencave.

Gjatë vitit 2022 njesia ka pasur mesatarisht 45 të punësuar.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK).

Pasqyrat Financiare janë individuale.

Përgatitja dhe hartimi është kryer në bazë të regjistrimeve kontabel të mbajtura për qëllime të raportimit konform Ligjit “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike dhe sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri, deklaratimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

2.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes (vazhdim)

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Lek /EUR	114.23	120.76
Lek /USD	107.05	106.54

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me kerkesat e SKK të përmiresuara, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rëndësishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kerkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhes raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikërisht në priudhën kur merren përfitimet.

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

M. C. INERTE SHPK

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

3. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare në datën 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon.

	31.12.2022	31.12.2021
Llogari Bankare	22,895,879	4,582,338
Mjete monetare ne dore	3,193,911	3,837,973
TOTAL	26,089,789	8,420,311

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4. Të drejta të arkëtueshme

Gjendja e kërkesave për arkëtim në datën 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon.

	31.12.2022	31.12.2021
Kliente shitje e shërbime	515,827,082	521,269,230
Parapagime Tatim Fitimi	14,082,365	12,396,496
Parapagime TVSh	14,380,608	15,298,046
Huadhenie afatshkurtra per pale te lidhura	54,898,350	
TOTAL	599,188,406	548,963,772

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

5. Inventarët

Gjendja e inventarëve në datën 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon.

	31.12.2022	31.12.2021
Materiale te para	10,844,729	1,347,936
Inventar i imet	3,731,122	0
Situacione ndertimore (Nexho Konomi)	1,145,217,608	1,295,700,210
Parapagime per inventare	20,639,670	0
TOTAL	1,180,433,129	1,297,048,146

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

M. C. INERTE SHPK**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata në datën 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon.

Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		54,683,200			54,683,200
2	Ndertime		234,235,865	2,026,667		236,262,532
3	Makineri dhe pajisje		21,343,940	41,262,290	2,827,665	59,778,565
4	Mjete transporti		85,165,882	464,000	0	85,629,882
5	Pajisje Zyre		13,772,018	7,262,519	1,190,000	19,844,537
	TOTALI		409,200,905	51,015,476	4,017,665	456,198,716

Amortizimi A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		0	0	0	0
2	Ndertime		24,081,021	10,583,742		34,664,763
3	Makineri dhe pajisje		0	6,291,160		6,291,160
4	Mjete transporti		23,814,619	12,277,986		36,092,605
5	Pajisje Zyre		6,425,119	2,538,036	238,000	8,725,155
	TOTALI		54,320,759	31,690,924	238,000	85,773,683

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	Toka		54,683,200	0	0	54,683,200
2	Ndertime		210,154,844	2,026,667	10,583,742	201,597,769
3	Makineri dhe pajisje		21,343,940	41,262,290	9,118,825	53,487,405
4	Mjete transporti		61,351,263	464,000	12,277,986	49,537,277
5	Pajisje Zyre		7,346,899	7,262,519	3,490,036	11,119,382
	TOTALI		354,880,146	51,015,476	35,470,589	370,425,033

Aktivët afatgjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Ne vijim paraqiten normat e amortizimit sipas kategorive të aktiveve afatgjata.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndertime	Vlera e mbetur	5%
Makineri, Pajisje, Zyre, etj	Vlera e mbetur	20%

M. C. INERTE SHPK**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

7. Të pagueshme për aktivitetin

Gjendja e detyrimeve tregtare, të papaguar në datën 31 Dhjetor 2022 paraqitet si vijon:

	31.12.2022	31.12.2021
Detyrime ndaj furnitoreve për blerje e shërbime	1,482,931,544	1,584,405,545
Paga të pagueshme	1,840,127	
Te pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore	605,215	413,488
Detyrime për TAP-in	48,160	44,961
TOTAL	1,485,425,046	1,584,863,994

8. Të tjera të pagueshme afatgjata

Detyrimet e tjera në datën 31 Dhjetor 2022 paraqesin arkëtime për porosi të ambienteve ndërtimore si dhe financime të kryera nga aksionarët prej pagesave të detyrimeve operacionale si vijon.

	31.12.2022	31.12.2021
Shuma të arketuara për porosi ndërtimi	145,719,944	88,960,021
Hua të marra nga aksionarët	59,813,515	60,450,729
TOTAL	205,533,459	149,410,750

9. Fitimi / Humbja e mbartur

Humbja e mbartur datën 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si vijon.

	2022	2021
Gjendja në 1 Janar	-100,255,528	131,115,374
Fitimi / Humbja e vitit të mëparshëm	14,863,965	76,629,098
Njohja e humbjeve nga zhvlerësimi i aseteve		-308,000,000
Gjendja në 31 Dhjetor	-85,391,564	-100,255,528

Shoqëria njohu në humbje të mbartura në periudhën 2021 shumën të mbajtura si shpenzime të shtyra për shkak të humbjes së vlerës së tyre.

M. C. INERTE SHPK**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në Lek)

10. Të ardhura të tjera nga veprimtarite e shfrytëzimit

Paraqiten të detajuara të ardhurat e realizuara dhe të njohura për periudhën që raportohet.

	31.12.2022	31.12.2021
Shitje punime e sherbime	73,824,622	144,911,934
Shitja mallra	33,209,281	18,470,744
Shitje materiale furnitura	16,438,079	4,603,050
Qira	393,496	468,142
Te ardhura nga Mirembajtje	90,693	82,000
TOTAL	123,956,171	168,535,870

11. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Paraqiten të detajuara të ardhurat e realizuara dhe të njohura për periudhën që raportohet.

	31.12.2022	31.12.2021
Shitje AAM	4,884,454	504,589
Shitje ndertime te investimit (Nexho Konomi)	235,129,066	294,471,515
TOTAL	240,013,520	294,976,104

12. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Paraqiten shpenzimet për materiale dhe kosto të drejtpërdrejta për periudhën që raportohet.

	31.12.2022	31.12.2021
Blerje materiale te para	37,979,524	127,312,396
Blerje mallra	16,446,593	
Blerje materiale te tjera	9,261,201	
Blerje punime te nenkontraktuara	24,471,841	
Kosto shitje Nexho Konomi	150,482,602	227,321,001
TOTAL	238,641,761	354,633,397

M. C. INERTE SHPK**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

(Të gjitha shumatat janë paraqitur në Lek)

13. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Paraqiten shpenzimet e tjera operacionale për periudhen që raportohet.

	31.12.2022	31.12.2021
Shpenzime siguracione	21,687,758	453,370
Sherbime hipotekore	13,417,033	0
Shpenzime taksa vendore	4,493,610	7,809,234
Tatime e taksa te tjera	3,971,517	287,500
Vlera e mbetur e AAM te shitura	3,779,665	340,000
Mirembajtje dhe riparime	2,309,383	1,356,361
Shpenzim avokatie,eksperte, Gjyqje etj	1,727,926	1,217,169
Humbje nga kembimet valutore	818,306	0
Gjoha dhe interesa	680,592	32,279,563
Transferime, udhetim, dieta	529,166	99,240
Shpenzime telefoni	493,669	534,568
Shpenzime te tjera	421,812	606,126
Blerje kancelari	138,642	109,476
Komisione bankare	130,084	285,449
Shpenzime nentrajtime te pergjitheshme	0	378,878
TOTAL	54,599,163	45,756,934

14. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Paraqiten llogaritja e tatimit mbi fitimin. Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2022 (2021: 15%).

	31.12.2022	31.12.2021
Fitimi para tatimit	12,737,481	23,183,411
Gjoha dhe penalitete	680,592	32,279,563
Shpenzime te panjohura		
Rezultati Fiskal I tatueshem	13,418,073	55,462,974
Tatimi mbi Fitimin 15%	2,012,711	8,319,446

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

15. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme dhe mjete monetare që sigurohen drejtpërdrejt nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit dhe të monedhës. Drejtimi i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë dhe kreditë.

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi ajo ndërmerr transaksione në monedhë të huaj dhe si pasojë ekspozohet ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve.

16. Palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Përsonat drejtues të shoqërisë konsiderohen palë të lidhura në kuptimin e këtij raportimi. Këto transaksione realizohen sipas afateve dhe normave të tregut.

17. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës 31 Dhjetor 2022 e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.